

## INTERVISTË ME SOKOL BEQIRIN

Pejë | Data: 5 maj, 2018

Kohëzgjatja: 78 minuta

Të pranishëm:

1. Sokol Beqiri (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Rozafa Imami (Intervistuesja)
4. Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Erëmirë Krasniqi:** Mendum me fillu me kujtimet e tua ma t'hershme, jetën n'familje, rrethin edhe qysh ka qenë atëhere, prej asaj që t'kujtohet, qysh ka qenë jeta në Pejë?

**Sokol Beqiri:** Jeta në Pejë, në princip une e kom pasë, fatmirësisht, një fëmijëri shumë t'mirë. Domethonë, në krejt kuptimin e mundshëm, domethonë si fëmijë edhe kërkesat i ki të limitume. Bile, bile kom pasë sende ma shumë se që ndoshta edhe u konë normal për rrethin. Domethonë falë prindërve të mij. Jeta u konë në Pejë interesant valla. U konë ndryshe, fëmijët jonë konë ndryshe, që osht' shumë e natyshme, prej...

Mirëpo, e kom pasë një fëmijëri t'lumtur muj me thonë. Nuk m'ka mungu kurgjo, kom kalu mirë, kom jetu mirë. Shumë herët ja kom nisë me udhëtu. Nihere afër këtu, vetë domethonë. Falë përkrahjes t'babës prej atëhere. Në klasën e katërt herën e parë jom shku në Deçan me shator, vetum, fëmijë krejt. E kështu kom vazhdu manej deri në moshën e adoleshencës. Tona kom fillu pak ma lerg, pak ma lerg. Pak n'deti deri në Dubrovnik, tona dej në Paris, tona me *interrail*<sup>1</sup>. Atëhere nuk u konë e zakonshme me udhëtu. E kom pasë zakon me udhëtu me *interrail*. Muj me thonë e kom pasë një fëmijëri shumë të mirë, a?

**Erëmirë Krasniqi:** Në cilin vit keni lindë?

**Sokol Beqiri:** Nuk m'kujtohet as një send i keq që kish me m'dhonë ndonji kujtim të keq përshebull.

**Erëmirë Krasniqi:** Diçka për familjën tuaj t'ngushtë, sa fëmijë keni qenë...

**Sokol Beqiri:** Familja e ngushtë, na jena konë dy, unë e nana, nana, baba, dy motra, dy vëllazën. Doemthonë dy motra ma t'vjetra, une edhe vëllau i vogël. Diku në moshën, sa po i bjen, në vitin e parë në gjimnaz, domethonë 17, 18 vjet... masi baba punojke në Prishtinë, familja është shpërngulë atje, une e kom shty edhe nja dy vjet kom ndejtë këtu, me gjyshën vetum.

Mandej jom shku në Prishtinë edhe une. Në shkollë t'mesme, studimet. Po s'kom mujtë me u adaptu. Gjatë studimeve jom adaptu se jom konë shumë ambicioz, shumë i etshëm me njoftë. Edhe i vetmi vend ku unë mujsha me folë, jom konë i qerrumë kështu mbas artit, qaq sa mujsha, mujsha në Prishtinë me kolegët e studimeve. Atëhere pak a shumë kom mujtë ma shumë me ndejtë.

<sup>1</sup> Ang.: *International Rail*, hekurudha ndërkombëtare.

Mirëpo mbasi jom shku, mbas studimeve në Lublanë, në studimet pas diplomike, jom kthy drejt e në Pejë. Nuk e di çka m’lidhë me këtë vend, m’pëlqen. Po mendoj, kisha ndrru shumëçka por qyteti si qytet, ambienti si ambient m’doket i mirë shumë.

**Erëmirë Krasniqi:** A t’kthehemi te familja prapë, se s’po du me shku shumë shpejtë...

**Sokol Beqiri:** Po...

**Erëmirë Krasniqi:** Meqenëse kur folëm privatisht pat’ shumë tregime tjera të familjes, deshta mu ndalë nihere edhe te baba juj, çka ka bo edhe çfarë influence ka pasë në juve edhe çfarë raporti ka qenë?

**Sokol Beqiri:** Baba im, n’fillim unë jom konë fëmijë kur ai ka studiu në Beograd. Ai ka fillu në moshën 35 vjeçare me studiu. Njo prej sendeve që m’doket interesant edhe mburra me to... domethonë në moshën 35 vjeçare ka shku, na jena konë veç tre fëmijë ktu, ka shku në Beograd ka studiu. Mandej nji kohë ka punu atje. Edhe viteve ’70-ta u kthy. Fillimisht ka punu si dizajner në fabrikë të mobiljeve në “Napredak”, Prishtinë edhe në Tefik Çanga. Mandej ka fillu edhe projekte të enterierit, qysh osht’ “Arabeska” në Prishtinë, një prej kafeve shumë t’frekuentume të asaj kohës.

Mandej ka fillu me dhonë mësim në Akademi të Arteve, teorinë e hapësirës. Edhe kom pasë përkrahje jashtëzakonisht të madhe prej tij. Çka osht’ interesant ndoshta për këto që i përmenda, ai ka fillu 35 vjeçar me studiu edhe ka mërru për shembull në moshën 65 vjeçare osht’ njo prej arkitektave t’parë sa e di une në Kosovë që e ka përdorë kompjuterin, autokadin, 3D studio në Kosovë. Edhe ma interesant se kjo, se ai nuk ka ditë as nji fjalë anglisht. E këto programe i ka mësu, i ka lexu domethonë ato komandat shqip, “File”, “Save”. Edhe s’e ka pengu në asnji moment domethonë me konë në trend me kohën.

Falë qasaj natyrisht se te na, mundesh me marrë me mend sa na ka përkrahë neve (kollitet). Konkretisht mu, për shembull. Une deri, deri sa s’ka vdekë ai unë jom njoftë këtu si njeri që s’ka punu kurrë. Domethonë, veç pse ai ka besu n’ata që unë jom t’u e bo. Edhe pa asnjë rezervë të mundshme m’ka përkrahë. Edhe udhëtimet e mia që unë s’jom konë bash i rahatshëm, kom livritë nonstop. Edhe punën në atele, edhe materialet edhe nuk di... në çdo aspekt të mundshëm. E kom pasë qat’ fat...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ke vendosë me studiu art?

**Sokol Beqiri:** Uh, kjo osht’ interesant. Unë në princip si i ri e kom pasë andërr me dalë jashtë. *The west is the best* [Perëndimi është më i miri] u konë parolla. Edhe mbasi, atëhere na mbas shkollës t’mesme u konë, shkojshim ushtarë menihere, u konë qashtu me ligj. Edhe une kur u ktheva prej studimeve, prej ushtrisë... nji vjet nejta, s’disha me bo kurgjo, pritsha me dalë jashtë. Edhe pritsha ai me m’i ndreqë letrat me nji shok, që une me dalë në perëndim edhe me punu, si krejt dynjeja edhe me bo pare.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë e zakonshme për atë kohë?

**Sokol Beqiri:** Jo, unë gjithmonë e kom pasë, ndoshta prej muzikës që e kom ndigu, a din, e kom pasë andërr perëndimin, Jim Morrison. Edhe pa ndonji ide t’caktume pse. Po mandena kur jom kthy ktu,

une t'u pritë me m'ndihmu ata, që mos me shku unë bash ilegalisht, domethonë me shku me njëfarë forme të rregullt. Edhe si një kujdes ndaj asaj që ai po provon së paku me ma plotësu atë dëshirë. Edhe ai me një moment u konë profesor në Akademi ka thonë, "Pse nuk po shkon në Akademi veç me kqyrë, me ushtru masi..." Se une vazhdimisht shfletojsha libra të muzeumeve, kqyrsha piktura. Po pa idenë që une muj me bo, as nuk kom provu me vizatu kurrë. Edhe thotë, "Pse nuk shkon, masi ki qef, shkon e provon edhe t'pëlqeftë mësohesh, kjo mësohet". "S'di," thojsha. "Shko".

Edhe une hajt me ja bo qefin, shkoj. Po qe unë dashunohna keq n'atë punë për një, gati 30 vjet pa ndalë. Domethonë prej momentit kur jam dalë, jam dalë krejt... edhe kur unë fillova, fillimisht kom ushtru me to edhe me Agim Çavdarbashën. Edhe kur e pashë që, vizatim, po u mësojka nuk koka kjo diçka talent që po ta jepka dikush. Po është punë, si çdo punë që e mëson. Një e një bojnë dy, qikjo matet qishtu, qishtu vendoset. Veç duhet me dashtë me punu.

Edhe kur e pashë që une po muj edhe ja nisi me m'hi n'qef krejt ajo punë, une bukvalisht u qërrova mas asaj pune. Edhe për 25 vjet nuk jam ndalë. Edhe tona, vitin e ardhshëm... Mu n'princip edhe mbasi ish ai profesor, një djalë nuk vazhdojke edhe pse u pranu studimet, ish një ide që une me mujtë me... le ta provon një vjet, le ta sheh a përnime po don. Edhe une vitin e ardhshëm konkurova n'grafikë, u pranova edhe vazhdova me punu me atë tempo t'njejtë.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ju mësojshin grafikë n'atë kohë?

**Sokol Beqiri:** Në atë kohë, në atë kohë krejt fatkeqësisht deri vonë, tash kanë fillu ndoshta do tendenca ma shumë se ndërrime. Jena konë t'përmbyllur njëfarë ekspresionizmi abstrakt me njëfarë nacional-romantizmi, me njëfarë ideje që e kena një prejardhje, edhe një traditë, edhe një kulturë, a din? Edhe pak diçka kena mësu n'atë kuptim.

Une kom pasë fat, jom shku me dëshirë teme edhe me vullnet temin, prej përshtypjes që ma ka lonë Nysret Salihamixhiqi. Edhe kom shku jom, bukvalisht jom shoqnu me Nysretin edhe ja kom pa hajrin në çdo kuptim. Se u konë një pedagog i hapun, edhe i vetmi që ka mujtë me t'orientu pak ma gjon me i pa sendet. Edhe Zoran Jovanoviçin...

Aspektin konceptual nuk osht' që kena mësu diçka. E kena mësu ma shumë, pak a shumë si pjesë zanati, qysh bohet një kompozicion, qysh... domethonë, edhe ata në formën ma klasike të mundshme në histori të artit, kemi mësu deri te Pikaso diku edhe kurgjo ma... edhe përveç disa individëve që jonë veçu si Nysreti, Zoran Jovanoviç, Muslim Mulliqi, a din? Disa njerëz që na kanë ofru pak... mirëpo, u konë e mbyllne Akademia atëhere ndaj, n'qatë periudhë t'vitet të '60-ta domethonë.

Mandej edhe teknikisht, për shembull une mbasi jom shku n'grafikë nuk kena mujtë, jemi konë t'limitum sepse nuk kemi pasë për shembull pllaka t'zinkut ku me gjetë për me i zhvillu teknikat e ndryshme. Po me qato çka mujshim me gjetë, kryesisht aty-këtu ndonji pllakë t'vogël na i gjejke dikush. Mos t'thom teknikisht u konë imporizivim veç sa me mësu zanatin, teknikën qysh diçka riprodokohet.

**Erëmirë Krasniqi:** Kështu, grafika ka pasë një nivel koxha t'lartë në Jugosllavi, a po?

**Sokol Beqiri:** U konë, u konë, u konë grafika po falë... përqata unë vendosi me shku në Lublanë në studimet pas diplomike edhe pse m'pëlqejke njifarë ekspresionizmi kështu edhe litografija si teknikë që këtu nuk kish. Në Lublanë ish shumë e anavcume. Edhe u konë, Lublana e ka pasë Bienalën e Grafikës, që u konë njo prej Bienaleve ma t'randësishme në botë më thonë për grafikë.

Kanë pasë Institutin e Grafikës, edhe qajo u konë motivi faktishikt që unë jom shku mandej në Lublanë me specializu grafikën. Edhe domethonë mbas studimeve këtu, kom shku atje, kom punu poashtu me të njejtin pasion kom bo, mos t'thom me dhjetra, qindra grafika. Edhe mandej kur jom kthy këtu mas nji kohë, muj me thonë shumë shkurt atëhere ndodhën shumë sende tjera mandej. Kisha Venedikun ngat, shkojsha në Bienalën e Venedikut edhe ia nisa, thjeshtë ia nisi mos me m'knaqë ajo punë që une e bojsha deri, deri atëhere, a din? Edhe me ambicien që e kisha nuk dojsha thjeshtë, këto e kom përmendë nji qind herë ndoshta po kjo intervistë tjetër... thjesht nuk dojsha grafika jeme, ose piktura, se unë u merrsha në të njejtën kohë edhe me pikturë, me përfundu në dhomë t'fjetjes diku edhe... se kisha nevojë, kisha thjeshtë nevojë ma shumë. Edhe mendojsha që jom ma shumë, dojsha me ndërru botën.

Edhe ia nisa nji kohë me dilema, me kriza, çka ajo qe duhët me u bo masi qekjo s'koka art, çka osht' ajo që... edhe atëhere ia nisa, m'u doke ma s'interesanti as vet nuk e di pse, video. Video duhet me konë, deri sa e bona ni video nuk u rahatova. Mandej vazhdova edhe dy, edhe tri. Mandej m'u doke performimi ma interesant, se komunikimi direkt m'pëlqejke. Domethonë, faktikisht m'pëlqejke ideja që, qasi bindje kom pasë, e boj kta veç për me e bo për veti, edhe nuk ka nevojë as me u dokumentu, as me u... domethonë, une e përçoj mesazhin t'cilin du edhe me qaq kryhet krejt ajo punë. Si edhe nuk m'duket keq prej këtij momentit, që mos t'ish konë Shkëlzen Maliqi që u konë, po thom përkrahësi jem ma i madh, atëhere une jom konë shumë ma i ri. Për çdo send që e bojsha diku, as s'e di ku e merrke vesh, veç u vizatoke aty edhe shkrujke, shkrujke për atë tekst.

Edhe unë si i ri domethonë, mos me t'thonë që kur jom kthy prej Lublanës une fillova me marrë pjesë në Bineale të Grafikës që e kisha andërr. Jo veç këtu, edhe në Milano, edhe në Peru, edhe në Spanjë, edhe në Holandë. Domethanë karriera e grafikës koxha si mirë me shku, po une thjeshtë e lashë.

**Erëmirë Krasniqi:** Veç me prekë pak edhe, po m'intereson për hapësinën ekspozuse që kanë ekzistuar në të '80-tat?

**Sokol Beqiri:** Fillimisht u konë u konë, në Kosovë u konë veç...

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendoj qysh, në çfarë hapësinë keni ekspozuar në Kosovë?

**Sokol Beqiri:** U konë veç Galeria Kombëtare e Arteve, që u konë Boro Ramiz atëhere, me drejtor Shyqri Nimani. Edhe muj me t'thonë që për kohën ajo ka funksionu shumë mirë. Shyqa ka ditë me bo shumë ekspozita t'mira. Kryesisht, ka pasë edhe ekspozita ndërkombëtare kështu, po atëhere kryesisht jonë konë të artistave të ish Jugosllavisë, po që jonë konë artista të kalibrit... u konë Edo Murtić, a din ekspozita, Safet... ose Zuko Gjumar. Edhe muj me t'thonë që kohë t'gjatë mas Shyqës nuk u udhëheqë Galeria qysh... domethonë, ama u konë e vetmja hapësinë sa e di une që ka ekzistuar,

edhe qekjo hapësinë ku jena na [Galeria e Arteve në Pejë], po ka qenë gati e pashfrytëzueshme, s'e di as çka u bojke këtu.

Domethonë qajo u konë çka u bo edhe mandej krejt ato, kryesisht jonë organizu përmes Shoqatës të Artistëve Figurativë disa ekspozita jo pranverore, salloni ky, salloni ai. I kanë mbledhë disa punime pa ndonji koncept t'qartë. Nuk ka pasë ndonji strategji ose koncept t'zhvillimit. Përveç që Galeria në kohë të Shyqës mos me thonë që ka funksionu shumë mirë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë naj hapësinë tjetër alternative, naj qendër?

**Sokol Beqiri:** Jo. Mu, se di, diçka alternative dojshin diçka, e t'rinjët nuk mujshin me ekspozu në Galeri. U konë njifarë, nuk ka mujtë aty bash, ksi... edhe domthonë na i shfrytëzojshim do hapësina të Boro Ramizit, improvizojshim me do... improvizime kryesisht. Nuk ka pasë ndonji hapësinë t'caktume ku ti ki mujtë me...

**Erëmirë Krasniqi:** Mrena universitetit a ka pasë diçka?

**Sokol Beqiri:** Jo, jo. Mrenda universitetit e bojshim ekspozitën vjetore. Edhe ekspozojshim nëpër atele, secili në atele t'vet. Domethonë ajo u konë ma shumë rezultatat, që profesori e kallzojke punën çka ka bo me studenta domethonë, e qitke, favorizojke një student. Ma shumë faktikisht profesori kallzojke rezultatit e tij. Nuk ka pasë ndonji aktivitet që mundem me veçu kështu.

**Erëmirë Krasniqi:** Ju keni qenë edhe, qysh e përmende edhe student i Muslim Mulliqit, apo...

**Sokol Beqiri:** I Muslimit nuk jom konë student, po Muslimi u konë shok i babës, edhe Visari, djali i vet u konë gjeneratë me ne. Edhe ai kur vike me taku Visarin e ndijke një obligim me na folë tonve ka diçka. Edhe u konë shumë mahnitëse mënyra qysh ai i shpjegojke senet, u konë mjeshtër i paparë. Edhe une me ambicien teme, edhe privilegjin që baba e ka shok, unë iu ngjitsha qishtu {përplasë duart}. Edhe deri sa... tona delsha me ta edhe me pi. Bile, bile masi jom kthy prej Lublanës, kur vike në Pejë, ai ka dy-tri ditë ma shumë rrike me mu, se e kishim laminë pak t'përafërt. Edhe kom pasë nderin që m'ka trajtu si kolegë n'atë kohë, edhe çak u mundoshin me m'bindë që unë duhna, domethonë pas atyne rezultateve që veç i kisha n'grafikë.

Edhe isha njo ndoshta, jo ndoshta por sigurtë i vetmi që e kisha n'atë kohë masterin n'grafikë. Edhe u mundoshin me m'bindë që osht' mirë une me u kyçë në Akademi. Po une gjithë e kom pasë njifarë, edhe atëhere, njifarë doze t'rebelizmit mrenda që nuk m'ka pëlqy krejt ajo mënyrë qysh funksionon edhe kom vendosë me u rebelu. Edhe mandej kur kom fillu me i bo punët tjera, pak ka pasë debate që s'jena pajtu, a din, me të ndjerin, Agimin edhe me Muslimin që kjo a osht' kjo art, a s'osht'... a osht' nji send veç që kalon, thojsha na kalon tonve n'fund të fundit. Edhe, mirëpo jonë konë kështu konstruktive, jo...

Mirëpo kom pasë përkrahje prej tyne, e kom pasë nji, jom konë i privilegjum muj me thonë me, m'kanë qarrosë me shoqinë e tyne, edhe me çeltësinë që e kena pasë. M'kanë trajtu si kolegë. Që nuk u konë e rëndomtë për atë kohë për nji djalë t'ri me... kështu që s'muj me u anku në atë drejtim.

**Erëmirë Krasniqi:** Para se me ndërpre, kem t'u folë edhe për ekspozita të cilat...

**Sokol Beqiri:** Huh?

**Erëmirë Krasniqi:** Për ekspozitat me të cilat keni udhëtu, ku keni shku, çka keni hulumtu?

**Sokol Beqiri:** Po si, si, po si jom shku në Lublanë une jom bo anëtar i Shoqatës të Artistave Figurativ të Sllovenisë. Edhe mandej ata ishin shumë ma aktivë edhe shumë ma t'organizuar. Edhe mandej fillova me marrë pjesë nëpër qeto bienalet që une i konsiderojsha si ma t'randësishme t'grafikës. Edhe pak a shumë n'secilën prej tyne... unë n'disa jom konë disa herë, si në Bienale të Lublanës. Nja dy herë kom refuzu prej një patriotizmi t'pakuptushem temin që s'dojsha kurqysh me ma shkru mu *Yugoslavia*. Aty u reprezentojshin si nacionalitete tona, as s'e kom... po kjo sot m'doket komplet e budallakavt sa krenar jom ndi. Ata, megjithëse une kom refuzu nuk ma kanë hekë sllovenët po ma kanë qitë *Albania*. Edhe mu, atëhere Shqipnija e mbyllët, komplet. Edhe unë isha shumë krenarë me atë që, që m'doket sot me një send...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh kane qenë raportet me Shqipninë...

**Sokol Beqiri:** Kurgjo s'kena ditë, unë s'kom ditë kurgjo për Shqipninë. I kom ditë piktorët e social-realizmit... edhe atë kom pasë fat Ali Hadri e ka pasë, edhe e ka një koleksion fantastik të piktorëve të social-realizmit dhe e kom mujtë me i pa *live* pikturat. Nuk ka pasë kurfarë, une tek, nuk m'kujtohen saktësisht datat, '96 ose '97, e kom taku herën e parë Edin [Rama], sot kryeministrin, atëhere artist, në Bienale të Cetinjës. Edhe qekjo u konë hera e parë që unë e kom taku një artist prej Shqipnisë.

Mandej e kom taku Anri Salën në të 2000-tën në Paris. Mandej kur filloi, Edi Muka kur erdh na thirri në Onufër në '97-tën. Aty jom njoftu me Adrian Pacin, Alban Hajdinaj, edhe Edi fillimisht ke shumë i organizumë, i boni disa ekspozita kështu me karakter gjithëkombëtarë në Berlin, në Bern... m'kujtohet në Itali. Edhe aty e kishim mundësinë mu taku faktikisht. Krejt qata që, domethonë kushtimisht bashkë mendimtarët të kohës, që punojshim me...

**Erëmirë Krasniqi:** Po kështu në Jugosllavi a keni pasë naj mënyrë me ushqy atë ndjenjën e të qenurit shqiptar...

**Sokol Beqiri:** Ajo u konë ideja, ideja e ndjehunit... mu dikush ma ka tregu ni debat mes dikujt të Shqipnisë edhe dikujt të Kosovës për akuzat, "Ju nuk jemi boll patrioti. Ju nuk jeni kështu..." Edhe një përgjegjje e atij të Shqipnisë, m'duket Visar Zhiti u konë, m'ka pëlqy shumë, ka thonë, "Deri sa ju e keni pasë t'ndalume me konë shqiptarë, edhe vetëvetiu ti qat' pjesë të identitetit e ki mbrojtë ndoshta, na nuk e kemi pasë t'lejume me qenë njerëz". Është dallim shumë i madh, kështu që nuk jena marrë shumë me asi.

Kryesisht njerëzit që jena tubu, kushtimisht rreth Edi Mukës, jena konë njerëz me vizione pak ma t'hapuna ndaj edhe nacionalës edhe... domethonë jena konë pak a shumë krejt t'preokupumë me artin që osht' t'u ndodhë sot. Nuk kena...

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ka ndodhë politikisht në kohën kur ju keni qenë me studime në Prishtinë? E përmendët që ka pasë trazira.

**Sokol Beqiri:** Në Prishtinë, unë n'shköllë t'mesme kam fillu kur jonë konë demonstratat e '81-shit. Mandej vazhdimisht, kohë pas kohe. U konë, sa jom konë student, bile e kom pasë grunë shtatzane, kena nejtë nja tri-katë netë, a sa netë kena nejtë ne atë hallën e sporteve kur u mbyllën minatorët.

**Erëmirë Krasniqi:** Salla 1 tetori...

**Sokol Beqiri:** Po, po. Salla e sporteve në Prishtinë. Ata minatorët u mbyllën atje në zgafella, na mbyllëm në hallë t'sporteve aty. Edhe pak a shumë e kom ndi, nuk e di pse, njifarë obligimi me Luan Bylykbashin, me Gaz Domin, me... tash s'po m'kujtohen krejt emrat. E kena pasë si njifarë obligimi moral me konë në çdo send që ka ndodhë, demonstrata, protesta. Deri atëhere kanë ndodhë veç qeto, deri sa unë nuk kom shku në Lublanë, domethonë qeto kanë ndodhë.

**Erëmirë Krasniqi:** A komunikojshin qeto botna, a e informojshin njena tjetrën, po mendoj arti dhe politika?

**Sokol Beqiri:** Kush?

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendoj n'kohën kur shkojshin në studime a u ndikojke arti prej gjendjës politike? A komunikojshin...

**Sokol Beqiri:** Atëhere jo edhe qaq. Atëhere jom konë i dhonun mas njifarë ekspresionizmit abstrakt që ndoshta veç në formë ose në gjeste ka mujtë me i vretë ai tensioni pak, pak ai kaosi. Po jo në kuptimin përshkrues apo diçka që ka ndiku bash, bash direkt. Osht' shumë e natyrshme si çdo gjo që ndodhë, në një mënyrë ose tjetër, direkt osë indirekt ajo reflektohet. Mirëpo jo në kuptimin qysh ndodhë ma vonë, jo si ma vonë qysh m'ka ndodhë. Domethonë që jom marrë më një problem ndoshta politik të caktum edhe direkt iu kom qasë. Tek ma vonë kom fillu me u...

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendoj qysh me e konstrukt qetë pjesën... po mendoj a t'flasim për Slloveni edhe zhvillimi ju j si artist aty edhe mandej kthehemi në Kosovë në vitet e '90-ta edhe zhvillimin tënd këtu me një kontekst krejt të ri politik.

**Sokol Beqiri:** Po. Po, po... okej, une mbas, domethonë si i kom kry studimet, domethonë '89-ën, u konë akademia shtrejtë edhe une e kom dhanë provimin e fundit. Edhe e kom pasë ditën e fundit kur muj me apliku në Lublanë me Gani Llalloshtin. Edhe menxi e lutem qe mos, se na hupke krejt viti me na lëshu njifar vërtetimi që kena diploma. Atëhere u konë Jugosllavi. Edhe shkumë, u pranumë atje. Natyisht paragjykimet ndaj shqiptarëve kanë ekzist, jo veç në Slloveni, krejt. Edhe fillimisht e kena pasë vështirë me u intergru. Po punojshim une e Gania qaty, rrishim vetum disa mujë.

Deri sa nuk u bo një ndërrim i studentave atje. Dy studenta slloven shkunë në Holand, e dy holandez erdhën. Edhe na u miqasumë me holandez, edhe përmes holandezit, ai iu kallzoi që qy këta jonë njerëz normal, nuk kanë bishta. Edhe gradualisht na kanë pranu edhe na kanë pranu muj me thonë shumë mirë. U konë atmosferë krejt tjetër domethonë. Atëhere kanë fillu do zhgënjime t'para. Sa pak kena mësu na këtu në Akademi, sa konservativ, sa t'mbyllun jena konë. Sa sendin s'e kom ditë hiç, se



s'ka pasë atëhere internet. Domethonë s'ka pasë kush me t'orientu n'shumë sende. Edhe atje, domethonë me rrethana tjera, me pregaditja tjetër, me Zgrebin, nga Italia, nga Austria, dhe me ambicien dhe vullnetin që e kisha, qysh, ku, tu i pa sendet çka po ndodhin... Domethonë fillojnë edhe ato ndrrimet kncptuale në mu kadal dale me ndodhë.

Vazhdimisht jom konë i bindun që qysh ja kom nisë që s'di me vizatu jom mësu, gjithmonë m'u ka dukë që unë nuk di me vizatu. Edhe çka osht' qajo, hala nuk e di çka osht' qajo që osht' art. Domethonë qaj motivi u konë motori, gjeneratori kryesor që m'ka shti mu me... hajde grafikë, grafikë. Kur e pashë që po muj me i bo grafikat edhe që tash grafikat po ecin edhe mo kjo s'koka, do te thotë diçka tjetër... edhe vazhdimisht kom lypë çka osht' qajo diçka tjetër. Qajo u konë motori kryesor që m'ka shti me, me punu ndoshta, me hulumtu, mos me ndejtë rahat.

**Rozafa Imami:** Sa keni qëndru në Lublanë?

**Sokol Beqiri:** Hë?

**Rozafa Imami:** Sa keni...

**Sokol Beqiri:** Dy vjet. Dy vjet. Mandej dej sa jom shku me i kry procedurat e diplomimit. Diplomë s'kom marrë, hala s'kom diplomë. E kom një indeks që kom diplomu. Edhe i kom shkru para, vjet, parvjet atje në Akademi edhe thashë, "Qeshtu, unë po du me tërhekë diplomën". Se s'di as vet pse m'u tek, dojsha me shku atje. E tha, "Kur ke diplomu?" Unë thashë, "Para 30 vjetëve". Edhe ma ka kthy një "Hahaha!" Po, dy vjet domethonë, po mandej vitin e ardhshëm jom shku, e kom përgaditë, dy provime i kom pasë teorike, mandej temën e diplomës me mbrojtë. Në Slloveni, tash për një here ndodhë krejt tjetër gjo, a din? Në Slloveni, a din, me punën që e boj edhe pak a shumë me qysh fillunë me u zhvillu sendet, atje kisha mundësi tjera,

Atje kish galeri private, t'vogla që t'i merrshin për shembull punimet, ose i pëlqejshin dhe i shitshin. Edhe une n'të kohë nuk kish muj që nuk i shitsha dy grafika, ajo... une materialisht nuk jom konë edhe keq, se e kom pasë përkrahjen, qysh t'thashë n'fillim, t'babës e vazhdushme edhe t'mjaftushme. Mirëpo ideja që dikush po ta blen t'jepke njëfar vullneti, që edhe dikujt tjetër...

Mandej ekspozitën e parë, e kom bo me ata, qajo galeria që m'i shitke kohë pas kohë punimet. Ma kanë organizu një ekspozitë pak para se m'u kthy, atëhere kom punu veç grafikë, edhe pikturë, po kryesisht grafika. Domethonë ekspozita e parë personale që e kom bo. Edhe pse unë s'kom pasë personale, i kom pas tri krejt.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni pasë një mentor kështu që kishit dashtë me e përmendë që u ka jep diçka të vleshme?

**Sokol Beqiri:** Mentor t'vleshëm... une i përmenda këta i kom pasë prej mentorëve shokë n'fillime, Agim Çavdarbashën, Muslim Mulliqin. Po ma s'shumti që kom mësu janë Nysret Salihamixhiqi edhe Zoran Jovanoviqi. Une për sherr atëhere jom dalë krejt... se tash ti e kryjshe vitin e dytë si t'përgjithshëm. Edhe n'vit dytë ti duheshe me u orientu n'qoftëse je n'grafikë ose n'pikturë me cilin profesor po don me mësu. Edhe u konë e natyrshme n'atë kohë, krejt atëhere e pasë me zgjedhë

Fatmir Krypën, edhe s'ki pasë faktikisht tjetër për ata që jonë t'orientumë veç n'grafikë. Aty kanë dhonë edhe Hysni Krasniqi, e... po ata i kanë dhonë ata që jonë n'pikturë, por sekondare e kanë grafikën.

Edhe te Zoran Jovanoviqi, une shkoj te Zoran Jovanoviqi edhe u konë njifarë skandali n'atë kohë, se unë babën profesor, "Qysh ky po shkon te sërbi?"

**Erëmirë Krasniqi:** A n'gjuhë sërbe apo në cilën ka ligjeru?

**Sokol Beqiri:** Epo, nuk u shku kurrë shqiptari me mësu te sërbi. Edhe motivi i vetëm u konë që mu m'pëlqejshin grafikat e tij. Ai u konë super i çuditshëm, që mu m'ka ndihmu krejt ajo sjellje, pak kaotik, pak i papërqendrumë... po, s'di, ka pasë momente që ai veç t'ka drejtu qaq bukur, edhe qaq mirë t'i ka spjegu disa sende sa që... u konë i rondë me punu me to. Po shumë i kjartë, shumë dike me t'kallzu çka. Sidomos n'sende abstrakte, a din, që jonë mundësitë e hapuna shumë ai dike me të...

Une e mbaj n'mend njihere, ata punojshin aty, klasa e Fatmirit [Krypa], edhe ai qitke do, a din, figura t'ndryshme drapere, ata n'bazë t'qasaj u inspirojshin... edhe une jom konë vetëm n'këtë anë që diçka provojsha me bo edhe une, diçka kumeditë, sipas mendjen tem. Edhe vjen ai me një moment, qekjo u konë forma qysh ai komunikojke që mu m'pëlqejke. Vjen ai me një moment edhe thotë, 'Uhh, qekjo shumë bukur'. Edhe thotë bukur për një send që une e merrsha ngjyrën edhe para se me qitë n'punim, e provojsha n'letër, edhe mirë o ngjyra, edhe vazhdojsha. Edhe ai nuk m'tha për punimin që jom t'u e punu, qe une e jepsha krejt, po m'tha për letrën. Edhe natyrisht une mbeta edhe ata u keshën, "Hahaha," krejt. Tha, "Jo, jo. Mos u keshni po që une pse po t'kallzoj qe o mirë kjo". Edhe tha, "Qekjo formë, me qet formë po reagojnë qeshtu, qekjo..."

Domethonë tash unë e kuptova n'atë momet që ajo ngarkesa jeme me idenë që unë po du me bo diçka osht' n'princip pengesë, që unë nuk po i shoh sendet që nesër t'i vlerëson në bazë të disa kriteriumeve, t'iu them, t'cilave ai ty po t'i tregon qaty. Raporteve, forma, vija... që une e kom bo spontanisht. Domethonë aty, ti duhesh me konë i vetëdijshëm për procesin. Jo me konë rob i idesë po proces, edhe me ditë në momentin kur ka ndodhë një diçka që ti duhesh m'u...

Ose send i dytë, unë me ambiciet çfare i kom pasë, n'dytin vit menjhere du me punu grafikë. Qe qaty e ki njo n'kafiq, qekaq t'madhe {tregon me duar}. Edhe du me një pllakë, zakonisht punohet me një pllakë një ngjyrë, une du pesë ngjyra me një pllakë. Edhe ai Fatmiri u konë shumë i mirë, edhe me to kom pasë raport t'mirë, e thotë, "Nuk bon, se nuk mundesh me i bo dy t'njejta". Edhe une u demoralizova pak, thashë, "Po hajt, po provoj". Kur erdh ky, edhe une me atë zhgënjimin që e kisha thashë, "Po profesor po du, po nuk muj me i bo dy t'njejta". Tha, "E çka po t'vynë dy t'njejta?" Thashë, "Po grafika osht' për me u reproduku". "Po i bon tonat ndryshe-ndryshe. Ti shfrytëzoja aftësitë, ose mundsitë që t'jep teknologjia, teknika. Se qato sende që i bon ti me dorë nuk mundesh me i bo. Domethonë ti përfito prej teksturave, strukturave që mundesh me i nxirrë, edhe s'mundesh me dorë. E jo me i bo, çka po t'vynë me i pasë dhjetë t'njejta". Edhe ti thush, "Kadale, po mirë e ka". Edhe domethonë me qesi detale ai, nuk ka pasë...

Po, se m'vyke ndonihere m'vyke, une i bijsha 10-15 vizatime m'i shkelke, thojke, "Këto s'vynë, këto palidhje, këto..." Edhe tona ma vonë u kthejke, ma vone m'thirkë, "Hajde..." Serbisht, "Hajde. Qe kjo

osht' veç një lojë veç s'din gjithkush me lujtë". Domethonë e ka pasë njëfar forme t'çuditshme që ti dufshe me i... muj me thonë që kom mësu shumë prej tij.

**Erëmirë Krasniqi:** Në Slloveni a ke pasë një kush qeshtu, që t'ka nejtë afër? Pra a ka qenë...

**Sokol Beqiri:** Jo, jo. Në Slloveni bile para meje ka studiu Agim Çavdarbasha dhe m'ka orientu te një profesor i cili veç ish n'pension. Edhe nuk kom pasë zgjidhje shumë t'madhe. E kom pasë një profesor muj me thonë super konservativ. Mirëpo mu nuk m'ka pengu. A din, ka pasë momente kur thojke, "Kjo nuk bohet". Po nuk m'pengojke me bo, edhe n'fund, n'fund kom kalu mirë me to.

Edhe aty e kom pasë fatin si, domethonë përveç si ekspozitave që fillova me konë pjesëmarrës n'sende shumë t'randësishme. Mandej si pjesëtar i Akademisë të Sllovenisë, une e marr shpërblimin për grafikë në ekspozitën e krejt akademive t'studentave të Jugosllavisë. Ti ma s'pari si shqiptar a ishe a s'ishe, e plus ti demek, ish njëfar privilegji edhe për ta, qy shqiptari... a din? Edhe ajo tani pak ta lehtësoke krejt atë komunikim edhe me t'lonë pak ma rahat, edhe... Amo u konë shumë konservativ. Nuk mbaj n'mend ndonji send që kom mësu kumeditë çka...

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë Stupica atëhere, Gabrieli?

**Sokol Beqiri:** Huh?

**Erëmirë Krasniqi:** Gabriel Stupica a ka qenë hala aktiv?

**Sokol Beqiri:** Jo, Gabriel Stupica ka vdekë. Kadale...

**Erëmirë Krasniqi:** '94...

**Sokol Beqiri:** Gabriel Stupica, ai fantastik. Jo, atëhere u konë njëfar piktori që mu m'pëlqejke, po u konë i vështirë n'komunikim, njëfar Emerik Bernard. E kom pasë kështu si një prej t'preferumëve, u konë Emrik... kanë pasë vërtetë... Mandej atje kom njoftu do njerëz, që hala, sot e asaj dite i kom shokë. Kom komunikim hala me disa prej artistave që mandej m'ka ndodhë me ta ma vonë me marrë pjesë nëpër ekspozita të ndryshme. Ka ndodhë do që unë atëhere nuk kom mujtë, i kom kqyrë si yjet kur kalojnë, a din, nuk kom pasë qasje n'ta. Epo tani kom njoftu tjetër kund tash, a din, osht'...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u kthytë në Prishtinë apat, ose në Pejë...

**Sokol Beqiri:** U ktheva në Prishtinë do mujë, edhe menjihere u ktheva në Pejë apat. Se n'atë kohë, unë t'tregova n'fillim, i varur materialisht por edhe në Prishtinë jetojshin n'banesë edhe babën e qitën prej akademisë se u konë nënshkures i atij apelit, 212... edhe një prej t'parëve që e kanë hekë. Edhe ai s'u mërzitke fort se ashtu, ashtu u pat lodhë prej punës kështu. Këtu i kishim kushtet super t'mira, e kishim shpinë krejt. Edhe vendosëm që me ardhë këtu, edhe une natyrisht që m'konvenojke se e kisha atelenë, sa dushe. Një qind metra katror atele, edhe ai u pasë kujdesë krejt pajisjet me i ble une. Menjihere si jom kthy ma ka ble presjen e litografisë, gurtë e litografisë... unë s'di a punojnë sot në akademi litografi hala. Po m'doket që jo.

Po du me t'tregu sa e madhe u konë ajo përkrahja, përveç që s'ka lonë me punu diçka tjetër, u kujdes ai me i mbulu krejt çka kena pasë nevojë, une, fmitë e krejt. Domethonë edhe teknikisht, me i ble edhe pajisjet edhe krejt. Edhe natyrisht që jam kthy këtu, edhe me ambicien unë...

## Pjesa e Dytë

**Sokol Beqiri:** Mandej edhe një prej arsyeve osht' domethonë, që jom kony i lidhun prej fëminisë me Pejën, dy, hapësina, kushtet shumë ma t'mira. Tre, nuk kom pasë ambicie, domethonë nuk kisha unë ndonji ambicie që me bo diçka në Prishtinë, m'u bo profesor apo... e kundërta. Edhe fakti kur, se ndoshta fillova me kallzu n'fillim e s'e tregova. Kur Muslimi, e Agim Çavdarbasha e disa prej profesorëve atëhere, u mundoshin me m'bindë me, me konkuru me dhonë mësim n'akademi. Une t'tregova, e kom pasë njëfar rebelizmi kështu n'veti. Po çka osht' e çuditshme, baba ma ka përkrahë ata. Se thojke, "Jo se ajo t'merr, po pajtohna, se ajo t'merr qaq energji sa ti mo nuk mundesh me zbrazë krejt qata çka po don qetash".

Edhe atij ju ka dokë shumë okej kjo punë. Që osht' rast i rallë, se çdo babë thotë, "Po more, hin n'punë. Je profesor, e ki rrogën, e ki kta, respektin, ata..." Jo ai, ai m'ka përkrahë mu n'çdo gjë, deri n'fund. Edhe po asnjë rezervë.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ish situata n'qat kohë, a mujshit me ekspozu apo veç punojshit?

**Sokol Beqiri:** Jo. Kur jom kthy, une vazhdova edhe një kohë me, me ekspozu me grafika se ish okej. E merrshe ftesën, e paketojshe n'postë e çon grafikën kollaj. Unë këtu nuk kom pasë mo kurgjo, po nëpër qeta triennale, bienale kom vazhdu edhe një kohë t'shkurtë. Po tana nuk mujsha mo se nuk pranojsa. Si erdha këtu edhe dy grafika si bona edhe e lashë une. Edhe tona nisa me u marrë me sende tjera. Edhe ekspozita faktikisht nuk ka pasë, në Beograd e kena bo ekspozitën.

**Erëmirë Krasniqi:** "Përtej" ajo...

**Sokol Beqiri:** Po ajo u konë njo prej kështu me, me ekspozitë të dedikume. Ma shumë u konë një ekspozitë që u konë ma shumë provokim politik, një, një kemi dashtë me kallxu një vullnet, një guxim politik. Me shku me thonë, çka duhet me thonë në Beograd edhe kena punu punë special.

Mendoj që nuk, po mendoj u konë si gjest, si, si politik. Edhe ekspozita u konë okej, me një kuptim që paragjykimet jonë konë edhe në Beograd, edhe ata thjeshtë... para do dite bile e kom lexu bile njo prej intervistave që i qasen tash mbas, që ata nuk e kanë pritë. Unë s'kom provu kurrë, se nuk mendoj që osht' një send që duhet me iu shënu 20 vjetori, a din? 20 vjetori duhet me iu shënu sendeve, s'di që ka diçka këtu që duhet me ia shënu 20 vjet.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh erdh deri te qajo ekspozitë?

**Sokol Beqiri:** Huh?

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh erdh deri te qajo ekspozitë?

**Sokol Beqiri:** Ekspozita, ma s'pari Shkëlzeni ka punu për fondacionin Soros, u taku me Dejan Stretenoviqin edhe kanë thanë, tu bisedu, ata s'kanë ditë kurgjo për artin në Kosovë. Shkelzeni iu ka kallzu që ka do njerëz që provojnë me bo, ish kanë mirë kta edhe ka thonë, ata ishin kanë t'gatshëm, edhe ka thonë, "Po, more". Edhe e kanë pasë idenë njihere me shku gradualisht, jo me shku drejtë te veni, po a don me shku, hajde shkojmë drejtë. Edhe e kena bo mandej, menjihere mas ksej na kanë thirrë në Bienale të Cetinjës.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë me të njejtën punë?

**Sokol Beqiri:** T'njejtën punë, se t'njejtin vit u kanë. Ata kanë lypë t'njejtën punë, se u kanë shumë politike, shumë përshkruese për kohën. Edhe mandej nuk, kena ekspozu, kena ekspozu nëpër kafe, si krejt dynjeja.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ke reagimi i asaj pune n'qatë kohë po mendoj, qysh ke perceptimi, qysh e pritën njerzit atje?

**Sokol Beqiri:** A din qysh, perceptimin ti kur, une për veti kur e marr, mu m'interesojke çka mendon për shembull disa prej artistave që unë i kisha përcillë si student. U kanë njëfarë Mrdjan Majiq që m'pëlqejke, ose, ose ky bre, Jovan Despoti. Njerëz që, Dejan Stretenoviqi, njerëz që, të profesionit që unë i kom përcillë çka bojnë. Po ata për mu nuk kanë nij. Domethonë unë isha ma interesumë me ditë çka ata mendojnë për punën si punë, natyrisht si, si gjest politik aty u kanë ni rreth shumë i caktum, edhe i njerëzve ndryshe, që u kanë një pjesë shumë e vogël që pak a shumë e kanë pasë ndërgjegjën e ka bre ndërgjegjja për këtë çka po ndodhë. Edhe u kanë definitivisht një fillim i thyrjes të paragjykimit për ne qe nuk ka, domethonë paska edhe atje, po ndodhka diçka.

Kemi edhe qetë 20 vjetorin, Branisllav Demitrioviqi diçka. E mu m'interesojke çka thotë ai, çka... domethonë prej ktyne o pritë, se u kanë befasi definitivisht. Po nuk mendoj që u kanë diçka për...

**Rozafa Imami:** Po ma shumë, n'relacion me qysh u kanë situata atëhere, çfarë ndikimi ka pasë...

**Sokol Beqiri:** O atëhere u kanë, nuk ka pasë kumeditë çfarë ndikimi as këtu, as atje. Përveç që na ua kena ngacmu ndërgjegjën disa njerëzve. Këtu ka pasë reagime kryesisht negative, demek kta tradhëtar që i kanë trajtu, i kanë tradhëtu vlerat e përbashkëta. Unë i kom pasë tana do polemika me atë gazetarin, domethonë mu nuk m'kujtohet që na kena qëllime, tradhëtim i qëllimeve të përbashkëta, thashë, "Une s'e di që kom ndonji qëllim t'përbashkët me ty". Bash qekjo u kanë përgjigjja.

**Erëmirë Krasniqi:** Kush tjetër ka qenë? Ilir Bajri...

**Sokol Beqiri:** Ilir Bajri ka bo muzikën, Mehmeti [Behluli] edhe, edhe Maksi [Maksut Vezgishi], po. Edhe mandej, mbas asaj kena bo ekspozita si krejt dynjeja nëpër kafe.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ndodhke, me çka mujshit me realizu...

**Sokol Beqiri:** Jo, une, natyra e punës teme nuk u konë hiç problematike me vendosë n'kafe. Une veç njo e kom bo n'princip te Fatka, edhe pse Fatkën e kom kështu për qefi person, si karakter, si, si përkrahës... mos t'thom qat' kohë u konë përkrahësi ma i madh i kulturës n'përgjithësi, sot institucionet s'bojnë çka ka bo ai, qata edhe ka bankrotu bre.

**Erëmirë Krasniqi:** Fatka osht' naj karakter i Pejës?

**Sokol Beqiri:** Hani dy robertëve, jo hani i dy robertëve, Fatka. Fatka o llegendë. E ai krejt pe ksi... Mandej ma vonë u hapë kjo Galeria Dodona, une shkojsa po nuk kom pasë ekspozitë. E di që u konë e planifikume pak para luftës me bo një ekspozitë edhe, domethonë '97, '98. Edhe qaty ia nisë koncepti për videon që e kom bo t'parën une "Milka". "Milka" fillimisht, unë çdo send e kom mendu, domethonë prej momentit që une e kom pasë një ide deri në momentin që e kom realizu kanë ditë me shku një vjet, dy vjet. Se e kom lonë, jo s'po m'pëlqen, jo s'jom i knaqun, jo po du, jo s'po du, jo s'po m'pëlqen hiç...

E "Milka" si koncept ia ka nisë ma s'pari kur une kom dashtë me e bo një ekspozitë te Shkëlzeni. Edhe u konë, nuk u konë video, ka vyjtë me u bo performim. Kom dashtë me e marrë bukvalisht një lopë, me ngjyrosë si millkën. Atëhere ish fjala a ka UÇK, a s'ka UÇK, qishtu u folke hala. A jonë dalë, a s'jonë dalë a, pak para se me dalë n'skenë domthonë hera e parë. U konë idea me lidhë une ni lopë, lopë tamon me ngjyrosë si millkën, me shkru "Milka". Edhe me dalë, ajo u konë, u konë edhe podrumi i galerisë. Edhe u konë plan me dalë një kasap me maskë *live* në Galeri...

**Erëmirë Krasniqi:** Me pre a?

**Sokol Beqiri:** Po. Edhe normal ajo nuk u bo. Edhe mandej fillova mbas një kohë edhe këtu kom ardhë që... mbas luftës, ideja si ide osht' shumë përpara edhe e bona si video. Mandej menjëhere mbas luftës, une dojsa para luftës. Kur u vendoës n'bunker, unë e kom pasë shpinë edhe atelenë menjëhere përfundi bunkerit, qiky bunkeri këtu. Menjëhere përfundi. Edhe kur u vendosën policia aty, a din n'bunker, u konë njëfar stresi shumë i madh. Edhe une dojsa si lopë me shku me ngjyrosë atëhere t'pembe. Edhe qaty nuk m'ka përkrahë baba se u tutë. Edhe tona normal, si jom kthy mbas luftës e kom ngjyrose "Think pink" diçka, mendo pozitiv...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh, qysh e kalutë luftën? Mos t'ecim qaq shpejtë.

**Sokol Beqiri:** Luftën si krejt dynjeja. Edhe atëhere unë qeshtu nuk dojsa me dalë se u duhke me ndejtë këtu. Edhe pse baba m'lutke, "Hajt bile thirrmi fëmijët". Pak para se me ia nisë bombardimet domethonë. Une tonë kohën jom konë në Pejë, edhe kur u luftojke. Se në Pejë u luftu shumë përpara,

përreth, këto katundet. Jemi konë t'mbyllun, një vjet, një vjet e gjysë para, ma shumë. U konë normal stres, si tonë, krejt tjerët, shumë...

**Erëmirë Krasniqi:** A ke qëndru këtu...

**Sokol Beqiri:** Po, po. Ama mbas bombardimeve, mbas bombardimeve, kur kanë fillu bombardimet mbas t'dytës ditë, na kanë deportu. Une jom konë njo prej... n'qatë kohë kom punu une, n'qoftëse nuk e ki pa e ki n'katallog, do piktura, n'qoftë se e ki pa ekspozitën në Prishtinë, nuk di a e ki pa? Këtë që e kom pasë personalen, pata tri vjetëve, a? E ki në katallog, ta çonë Pera [Petrit Gora] me ksi. I ki do piktura që une mbas studimeve, edhe mbas shumë kohe kthehna me bo piktura apet. Se rrisim mbyllë n'shpi tonë ditën, në 12:00, nuk guxojshim me dalë kërka në rrugë, krejt u mshelshin. Edhe une i kom pasë do asi lesnita t'mëdhaj edhe hajt po pikturoj. Po ça kom bo, për herë t'parë që kom punu figura, une veç kur e kom pasë detyrë n'shkollë. Hera e parë që filloj, gjashtë piktura, që i kom bo piktura, kryesisht e kom pikturu veten, grunë. Edhe qaty o një periudhë që, edhe atë ditë...

**Erëmirë Krasniqi:** A figurative jonë a?

**Sokol Beqiri:** Ah?

**Erëmirë Krasniqi:** Përdorni figurim kështu n'to a?

**Sokol Beqiri:** Piktura me portrete, gruja, une, çika. A din se nuk kom bo kurrë asi sende, veç kur e kom pasë n'shkollë detyrë, "Hajt bone". Edhe e kom bo, po.

**Rozafa Imami:** A jonë këto që nuk kanë kry aa...

**Sokol Beqiri:** Ja, ja. Kjo tjetër osht'. Ato menjherë n'fillim të '90-ave kur kom vendosë që mo grafika e piktura s'du me m'përfundu n'dhomë t'fjetjës dikun. Edhe kom punu me shtresa t'mëdhaja t'ngjyrës. Jo pse kom pasë qef une, po vazhdimisht i pa kënaqun, u mloke, u krijoke vet ajo shtresa qashtu. Edhe njo prej pikturave qeshtu, pak ma e vogël se qekjo, e kom vendosë... e kom grujën, e kom n'tegëll, si me konzervu, si sendin që e konzervon për me rujtë për diçka, jo tash për me... e kjo jonë, kto jonë krejt tjera. Veç gjashtë piktura....

**Rozafa Imami:** A i ki hala këto?

**Sokol Beqiri:** Do i kom, do s'i kom. Po jonë konë n'ekspozitë në Prishtinë, n'katallog jonë. Që i sheh do portreta, do... kjo u konë fillimi i rebelizmit ndaj grafikës e pikturës kur e kom grry, i kom shti n'teglla, e qesi... e kom fotokopju vetvetën, a din, portreta bojsha kështu, n'vend se me vizatu e qitsha krytë n'fotokopjus edhe... domethonë qaq, fillimi i të '90-tave kur njëfar, Shkëlzeni thojke rebelim.

A din qysh, atëhere u konë problem, se tash filluan qito debatet me ta, Shkëlzeni u konë qaj përkrahësi që kudo që u ardhë ka shkru, edhe ka mbulu teorikisht me t'dhanat e historisë. Edhe sado-kudo ka pasë autoritet intelektual që ka thonë, "Kadale se nuk koka bash..." A din, se pa e pasë ti dikon si

*background* [prapavijë] teorik t'hajnë, a din? Jo, t'hajnë n'kuptimin që ti e hupë vetëbesimin, e hupë, edhe dorëzohesh, thu s'koka. A kur ai shkrujke, muj veç me t'rrejt që s'ma kojke, mu doke që çka jom tu bo une.

**Rozafa Imami:** Nashta kishim vazhdu qaty te koha e luftës çka ke punu ma shumë?

**Sokol Beqiri:** Gjatë luftës veç qeto i kom punu, veç qeto gjashtë...

**Erëmirë Krasniqi:** Portrete...

**Sokol Beqiri:** Po, piktura. Kryesisht t'grusë, temen. Nuk jonë bash komplet, veç me një moment gruja, tamon gruja. Edhe aty jom konë pak i inspirum prej Filip Gastonit. Kur n'atë fazën që e ka bo një pikturë sikur mos t'kisha pikturu kurrë. Edhe une du me bo ni portret sikur kurrë mos t'kisha bo shkollë, mos t'kisha mësu. E kom marrë një fotografi edhe kom shku, kom bo sikur kurrë mos t'kisha mësu kurgjo veç m'ka ardhë vet.

Edhe tona i kom zhvillu qato gjashtë piktura. S'po m'kujtohet që kom punu diçka tjetër. Jonë edhe do, s'po m'kujtohet. Qeto, qeto gjashtë piktura e di. Veç jonë t'formatit bajegi t'madh. Dy prej tyne jonë konë qetash në Dokumenta.

**Erëmirë Krasniqi:** Ku shkutë mandej në luftë?

**Sokol Beqiri:** Huh?

**Erëmirë Krasniqi:** A u strehutë gjatë luftës?

**Sokol Beqiri:** A din qysh, une jom konë, si sot e mbaj n'men... jom konë në atele t'u pikturu edhe nuk dojsa me asnjë kusht me dalë. Meri i ka pasë t'palume t'çikave do dokumenta, pare çka ka pasë, do elementare, n'torbë, n'gadishmëri. Edhe une jom konë... një prej pikturave që s'e kom kry kurrë, t'shtatën, jom konë t'u punu qeshtu, n'tokë punojsha, kur jonë hi te kojshitë aty. Edhe i kom pa t'u i deportu, edhe e kom pa që kjo nuk ka mo ksi. Jom hypë n'kerr, Reno katër edhe... tona e kom pa kolonë u konë krejt, mandej mbas...

**Erëmirë Krasniqi:** A keni shku në Shipni a?

**Sokol Beqiri:** Jo, turma t'çojke vetë. Edhe une i kom lonë, i kom lonë prindët n'shpi. Mirëpo n'gjysë t'rrugës mu m'tregunë, "Qy se edhe ata i kanë deportu edhe jonë t'u ardhë". Ata kanë ardhë n'komë mandej deri në Rozhajë. Mandej jena shku në Ulqin. Në Ulqin si shumica çka jonë konë. Edhe mandej menihere si u kry jena kthy.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh e gjetët shtëpinë?



**Sokol Beqiri:** Shpinë, a din qysh? Shpinë, qysh jonë kanë këtu krejt shpiat e kallne, e jonja u kanë veç e lagët. Domethonë nuk u kanë e kallne, edhe pse shpi e vjetër, kanë mujtë edhe ata lirisht, bile e kisha ndreqe prej fillimit. Po, çka kanë zbrazë aty, çka kanë marrë sendet krejt, n'fund e kanë lëshu ujin. Po çka osht' interesant, një ndodhi interesant çka ka ndodhë aty n'shpi teme. Aty ka ndejtë një kohë dikush. Edhe ai dikush, u hi edhe në atele te une, edhe ma ka ditë emnin. Nuk besoj që osht' dikush që mu m'ka njoftë personalisht. Po prej far katalogut ose diçka.

Edhe mu m'kanë lonë edhe mesazha, ato kom gabu që s'i kom dokumentu. Edhe performimet, se t'tregova n'fillim, se po harron njëri t'u folë, mos t'ish ardhë Shkelzeni m'i dokumentu, shumë sene s'kisha pasë une sot hiç. Ai u ardhë krejt fotografia e çarshisë që i kena bo, *Think pink*, krejt ai i ka bo, se une, "E boj, s'ka lidhje..."

E ata kanë pikturu me ngjyrna t'mia aty, n'mur direkt. Ma kanë shkru aty , edhe emnat i di, Tazamiksha, Nikolla, Dragoxhujo, Novi Beograd, bollk 70. Ma kanë shkru adresën. Edhe n'atele m'shkrujke aty, se kom fshi deri sa s'jom dalë prej shpisë, ma kanë shkru një mesazh, "Sokoli Serbia". Ma bojshin mu, "Pse s'pe fshinë?" Ja u bojsha, "Po s'po e fshi se mesazhi lehet dikujt që me lexu, une jom shumë i lumtur që erdha me lexu mesazhin".

Domethonë kanë shkru ata, kanë gjujtë me ngjyrna t'mia aty. Po nuk besoj që osht' dikush që mu m'ka njoftë, po thjeshtë kanë ndejtë aty, kumeditë kush, çka u bo aty nuk e di. Edhe domethonë shpia u kanë e pabanushme.

**Erëmirë Krasniqi:** A ja u kanë rujtë punimet ata ?

**Sokol Beqiri:** A? Po. Jo krejt, do, do piktura m'i kanë kanë çky, e mi kanë gjujtë, prej katit të tretë, ato t'mëdhaja, i kanë çky, i kanë marrë, i kanë pru poshtë, i kanë gjujtë në bazen. Ato veç, s'po di kush ka pasë nge m'u... e grafika m'kanë pshtu, disa jonë damtu se tash qysh kom pasë une shumë n'ato fijokat, ata kanë nxirrë ma shumë me kqyrë mos ka naj sen t'mshefne. Naj pare, e tona qysh jonë end, jonë shkelë, jonë bo. Po piktura po, piktura bajagi si shumë, gati, gati si, sot kom shumë pak.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u, qysh u riaktivizutë mandej mas luftës, po mendoj qysh e rimendutë krejt rolin e ju si artist?

**Sokol Beqiri:** Nihere, nihere une vendimin për, për mos m'u marrë me art e kom marrë shumë përpara. Po edhe njisoj si punët, e kom marrë ni vendim edhe tona ka vyjtë kohë. Osht' qaty n'tekst të Shkëlzenit, n'qet katalog një poezi, që ndihna i nderuar që ai, poezia e parë që e ka botu. Ai shkrunë, po nuk boton poezi. E qeta e ka botu, që e ka dediku familjes. Aty përmend çikat, nanën, babën, mu. Po me një sekuencë teme, një sekuencë ku përmendna unë thotë, m'përmend mu, thotë, "Ku e kish gjetë atë raki, e shërbejke të ftohtë". Edhe vazhdimisht e përsëritke, "Arti s'ka kuptim". Edhe domethonë une edhe atje s'dojsha... kjo definitivisht nuk ka kuptim, çka jom une që po du me, me... kjo osht' edhe...

Po tona, qysh thashë që nuk i kom realizu projektet, i kom pasë n'kry, edhe ka pasë boll asi. Mas luftës na u bonëm si banane, erdhën prej krejt dynjesë me pa kush jonë këta njerëz, çka jonë këta njerëz. Sigurisht erdhën njerëzit me pa edhe a ka njerëz që punojnë edhe n'art. Edhe thjeshtë ja nisi me pasë kërkesë. Unë veç i kisha, mu veç m'vyjke me shku me bo ni xhirim, me montu, punët e gatshme në princip. Edhe tona ja nisi me m'pëlqy ajo punë. Se udhëtojsa çdo tri javë diku, jo Francë, jo... m'u doke pak ma...

Edhe, mirëpo vazhdimit t'përcillme me një frustrim tjetër prej asaj që çka une kom pritë, çka une kom menu që kish vyjtë me konë art. Përshembull për mu, kur e kqyrsha një punë, unë mendojsa që ajo osht' reflektim i një karakterit t'artistit. Edhe po ia zojmë do prej artistave që m'kanë pëlqy, mos t'thom, punët që m'kanë pëlqy. Jo që m'kanë pëlqy, m'kanë, shumë m'kanë pëlqy. Kur m'ka ra rasti tash m'u taku me ata njerëz, me atë punë, edhe e kom pa atë dallimin mes karakterit t'vërtetë t'qetij njerit edhe moralizimit që ai p'e bon n'punë. Edhe mënyra qysh t'u u futë n'atë, kapak nuk o, që kom pasë rast tona me punu me njerëz që dikur veç ondërr i kom, kom mujtë me i pa. Ja ka nisë mos me m'pëlqy krejt ky muhabet, as ekspozita, as hapja, as...

Domethonë sidomos ajo pjesa që ti ma shumë shpenzon energji qysh me plasu, edhe me promovu veten, se sa punën që e bon, që puna si punë vetvetiu nuk... ose s'paku ato kriteret t'cilat unë ja kom caktu vetes nuk... domethonë, shifsha ekspozita që, unë thjeshtë mendojsa që s'duhet me konë. Mirëpo kom vazhdu me, vendimin e kom pru përpara, po tona deri në 2006 kom vazhdu se kom pasë, kom hala projekte që nuk i kom realizu kurrë.

**Erëmirë Krasniqi:** Keni qenë në 2002-tën n'Dokumenta, a po?

**Sokol Beqiri:** N'Dokumenta jom konë n'2017-tën, qetash.

**Erëmirë Krasniqi:** A s'jeni konë edhe 2002-tën...

**Sokol Beqiri:** Ja, hera e parë që...

**Erëmirë Krasniqi:** E Rene Blloku...

**Sokol Beqiri:** Në 2002-tën u konë Rene Blocku. Jom konë me Szeemannin... mandej me Szeemannin, kom punu "*Beauty of the Failure. Failure of the Beauty*" [Bukuria e dështimit. Dështimi i bukurisë] në Barcelonë. U konë prej Kandisky e Malevic e... ai ka bo ekspozita. Mandej Bienalin në Sevilë, Locarno Film Festival. U konë një pjesë ku u lshoshin videot...

**Erëmirë Krasniqi:** Pse kom mendu që krejt...

**Sokol Beqiri:** 2002, qito Blocku... jo, a din pse e ki lidhë ti? Se ekspozita e Bllokit u bo në ndërtesën e Dokumentave. Në 2002-tën, Dokumenta u konë qetash në, osht' hera e parë, osht' hera e parë që unë mbasj dhjetë vjetëve kom punu. I kom bo punët special për... edhe kur m'thirrën mu n'takim ma s'pari, unë jom shku jom taku, kom pasë m'u taku me Charlesin [Esche] e me Galitin [Eliat]. Edhe nuk

kom dashtë me bo prezentim, edhe me insistim të Erzenit, po Erzeni e ka dhonë katallogin. Edhe mandej kur kom shku u konë edhe Adami [Szymczyk], drejtori, edhe kena ndejtë. As nuk kom pa ondërr që, edhe pse deri sot nuk m'kanë çu signalla prej tjetër ka që Adami osht' t'u i pëlqy puna, e kështu.

N'atë moment i kom thonë, "E çka tash, mbas dhjetë vjetëve çka, çka boj une?" Edhe, nejse m'ka ra n'mend shumë shpejtë ajo, nuk u konë shumë problem. Po kur m'ka vetë Adami, kur jom shku, se t'njejtën ditë une e kom refuzu një ekspozitë për Ballkanin që u bo Pera Museum në Stamboll, nuk kom dashtë me marrë pjesë. Edhe ne muzeumin e artit modern në Budapest, arti bashkëkohor shqiptar, nuk kom dashtë me marrë pjesë. Thjeshtë, kom thonë s'marr mo pjesë.

Edhe Adami m'veti, tha, "E pse tash mu nuk po m'refuzon?" Edhe une ja spjegova shumë bukur, isha i përgaditur për këtë pyetje, edhe thashë, "A din qysh?" E morra me fe e lidha, thashë, "Për një musliman i cili e ka praktiku fenë me dashurinë ma t'madhe për 30 vjet, ondra osht' me dekë në Mekë. Edhe për një njeri që e ka parktiku 30 vjet artin me një dashuri, une e kom bo me një dashuri shumë t'madhe deri sa e kom bo", thashë, "Ondra osht' me lonë dokumenta, jo me lonë bash gjithka". Edhe thashë, "Për qato s'po t'refuzoj".

Mandej deri sa i përzgjidha, une s'disha as çka ka m'u konë. N'takimin e dytë i ka thonë Erzenit, "Ma mirë ish konë me Sokolin me folë për punë, se veç për ushqim e për venë". Po tash mu ma imponojshin atë temë, se jo kjo, a din. Edhe thashë, "Okej, cili ka me qenë kontributi jem?" Edhe ai n'fillim, ajo ke jo reale, gati ni mini retrospektivë, edhe grafikate m'i qitë, krejt njëfarë... Mirëpo, ajo ish jo reale, edhe n'kuptimin e hapësinës, edhe ksi. Tha, "Po ma s'shumti çka kisha pasë qef", se ai e ka lexu në katallog, këtë bisedën me Shkëlzenin edhe tha, "M'pëlqen forma qysh ti reagon n'situata t'ndryshme, sidomos..." Tha, "Une kisha pasë qef një punë t're".

Une veç e kisha punën, se kur m'ka thonë një shoqe mu që osht' t'u i pëlqy, që punon me Adamin, osht' shumë t'u i pëlqy puna edhe... tha, "Mu m'pëlqen mënyra qysh, edhe kisha pasë qef punë t're". Edhe une kur m'ka thonë, kom thonë, "Çka boj une tash?" Ish problem tash, ti duhesh me bo mbas dhjetë vjetëve ni punë, qe dhjetë vjet je çaraveshavë, ke thonë që nuk ka art, arti osht' palidhje. Kjo tash ta komplikon situatën, se tash ti mundesh me bo, e bon një punë edhe çka, ata po thojnë çdo ditë po na rren diçka, t'nesrit... a din, ke mujtë edhe ata, po une dojsha me çdo kusht me ndejtë brenda atidutës t'cilën e kom zhvillu këto dhjetë vjet. Edhe m'vyke me dhonë ni provë, kom thonë, "N'qoftë se artisti ka mision, ka mision me dëshmu që s'ka art". Që nuk osht' bash punë e lehtë. Edhe dojsha me dhonë s'paku një provë t'qasej, edhe i thashë Adami, ja shpalosa idenë edhe qishtu shkoj.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka keni bo qat' dhjetë vjet?

**Sokol Beqiri:** Ah?

**Erëmirë Krasniqi:** Çka keni bo qato dhjetë vjet jo aktivitet? Qysh i keni artikulu? (qeshë)

**Sokol Beqiri:** Kurgjo, kom *chillit*. (qeshin) Kom *chillit* dhjetë vjet qetu n'kafiq. I kom ndrru disa gjenerata. Tash Era e kta jonë gjenerata ma e re. M'kanë kalu disa nëpër... kurgjo, kom shëtitë, kom bo... e kanë vetë njihere, dy ksi [storie]me t'i tregu. Njihere çika e madhe, kur u konë krejt e vogël, Toska, edhe baba jem e veti “Çka e ki babën?” Edhe ajo kqyrke çka e kom babën. “Çka t'punon baba?” Tash ky po don m'i ndihmu, a din, m'i thonë piktur, edhe po ja bon “Pi - pi - pi...” Ajo tha, “Pijanec!” (qeshin) E dyta, e kjo tash po t'allzoj çka i ka thonë e dyta mësuesës, e qato kom bo këto dhjetë vjet tjera. Kur e ka vetë mësusja, “Çka t'punon baba?” Kjo i ka thonë, “Bon qejf”. (qeshin)

**Erëmirë Krasniqi:** Vështirë o...

**Sokol Beqiri:** Ajo osht' shumë vështirë. Këto dhjetë, domethonë kur kom vendosë me ndërpre, u kry projekti i EXIT-it, Galerisë, e vetmja mundësi ish tash me dalë unë, baba vdiq, nuk ka pare mo. Une nuk dojsa me ardhë në Prishtinë tash me bo apet, m'u marrë me, me kqyre fonde me bo fonde, une ata s'kom mujtë me bo kurrë. Edhe sendi ma i logjikshëm që u konë për mu, krejt jetën kom ndejtë n'kafe, me bo Galerinë kafe, edhe e kom bo. Kto artistat i kanë bo si art, a din, po une e kom bo *on going, on going* [në vazhdimësi], po.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë projekti i EXIT-it, edhe ai osht' koxha i randësishëm për artin bashkëkohor...

**Sokol Beqiri:** Une mendoj, une mendoj pa ndonji modesti që u konë projekti ma i mirë që ka ndodhë. Osht' si rezultat, n'qatë kohë ndodhë që kjo gjenerata që i thotë Rene Blloki, avant-garda, qato vjet jonë bo, ajo mëzri osht', krejt qita që jonë sot. Nuk mendoj që krejt u konë direkt prej EXIT-it po një kontribut t'mirë. Se kanë pasë mundësi me i njoftu njerëzit që jonë konë aktual n'skenë botërore, m'i taku, me folë, m'i pa ekspozitat këtu. Ai u konë një projekt i Bundes Kulturstiftung, e kanë bo njëfarë projekti *Realtion*. Edhe ata jonë dalë, n'princip ata jonë ardhë te na. Na kanë njoftu mu edhe Erzenin, i keni njoftu disa herë, jonë ardhë edhe ata kanë thonë, “A e boni ju një projekt na me...” E kanë pasë domethonë në Kroaci, në Kroaci, s'di a kanë pasë në Slloveni, në Kroaci, në Bosne, në Molldavi edhe te na. Po m'kujtohet qeto, nuk di a ka pasë edhe diku.

Edhe ata e kanë sponzoru një projekt t'cilin na e kena thirrë “*Missing Identity*”. [Identiteti i munguar] *Missing* se për shembull, me idenë që t'ritë këtu nuk po munden me udhëtu, me shku, me pa. Domethonë n'qoftëse ata na mundem m'i pru, tash i shfrytëzojshim faktikisht lidhjet që une e Erzeni ndërkohë i kishim bo nëpër ekspozita me artista. Edhe ata ishin t'gatshëm me ardhë edhe për shoqni, edhe për me pa Kosovën se ish atraktive. Po ma shumë e kanë bo për shoqni se që... edhe qashtu fillumë, erdhëm, thamë okej, e bonëm tonën. Edhe aty jom konë njihere me dilema mirëpo tash kur u bon krejt aty bashkë, une s'dojsa me prishë lojën, me thonë që une s'po du...

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë domethonë program edukativ, edhe ka pasë ekspozitë...

**Sokol Beqiri:** E kena pasë ekspozitën plus kurset u mbajshin. Librarinë, bajegi do libra i kena pru n'biblotekë, që i kanë marrë për me i kthy. Mandej u konë ndrrimi i studentëve me Städel Schule. Städel Schule se une e kom pasë andërr. Edhe domethonë, qaty kjo *missing, what is missing doesn't*

*hurt.* [Nuk dhemb ajo që s'e ke] Qaq, që çka t'mungon ti s'e din që, që t'mungon. Nuk t'dhem, a din? Edhe qaty e kena... mandej vishin studentat këtu. Kur vishin këtu, zgjedhni, a din, me pasë ata nji ndërrim t'qasjes. Edhe tant shkojshin në Frankfurt. Ajo u kanë mundësi për plotë studenta, herën e parë besa edhe me dalë jashtë Kosovës, me marrë vizën, me shku në Gjermani, me bo ekspozitë. A din, u kanë ni shtytje sa do...

**Rozafa Imami:** Cilët janë kanë a e mban n'mend?

**Sokol Beqiri:** Studentat a?

**Rozafa Imami:** Të Kosovës që kanë shku.

**Sokol Beqiri:** Te na që janë ardhë a? Krejt.

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, jo. Njerëzit prej Kosovës që kanë qenë të përfshimë n'projekt, prej studentave...

**Sokol Beqiri:** Prej studentave, nuk e di kush janë kanë. Janë kanë, e di që janë kanë, Jakupi [Ferri] u kanë. E kena kyqë si asistent atëhere. Ai Jakupi e dini, po u kanë Flaka, Flaka Haliti. U kanë, janë kanë edhe kta t'Jakupit. U kanë Lulzimi, janë kanë Alban Muja, krejt qeta që janë aktivë sot. Qaty, dove, dove që kanë provu me kanë aktiv po s'e kanë pasë vendin aty, si gjithkujt që i ndodhë, a din.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh ju doke vetja n'qet rol ma, n'rolin e profesorit, a keni qenë profesor?

**Sokol Beqiri:** Ah jo, jo. A din qysh? Jo, une e kom bo krejt qeshtu spontanisht. Une veç kom bo muhabet me, me... nuk, une n'princip rolin e profesorit e kom praktiku ton' kohën, se vazhdimisht kom ushtru, ka plotë t'ri që janë ardhë edhe n'kafiq këtu, me i ushtru une për akademi m'u përgaditë. "Po du me u regjistru, a m'ndihmon?" Edhe une iu kom ndihmu. Kanë ardhë n'kafiq, e kanë pi nji kafe edhe unë i kom korigju vizatimet, iu kom tregu, kom dhonë detyra, a din. Mandej kom pasë pak eksperiencë se kom majtë edhe workshope tona qeshtu, n'fund t'viteve 2000-ta kur m'kanë thirrë me studenta jashtë e kështu. Pak a shumë m'u ka bo rutinë si krejt profesorave, edhe pse s'jom kanë kurrë. Domethonë une fillimisht, ju, ju shpalos'sha punën teme edhe secilen me rend edhe mandej e, e gjojsa. Zakonisht më thirrshin për far teme t'caktume me u marrë edhe tona diçka, a di, çka osht' qekjo teme. Spontan, jo, jo n'kuptimin une profesori ti... une autoriteti, ti... po, qeshtu. Une nuk kom mbajtë msim une me thonë n'kuptim...

**Erëmirë Krasniqi:** Tash do t'ju pyes, a e keni ba këtë punë pak ma ndryshe?

**Sokol Beqiri:** Jo veç une në princip kom punu per secilin prej ktyne se krejt, se edhe kta shumica qe jon kanë ma të partë ma kanë pru një punë me ja kyqërë, une i kom dhonë një mendim temin. Ose më ka pëlqy krejt përnihër shumë, ose çka kom pasë ndonjë vërejtje. Domethonë, po m'pengon qekjo ose, e ka pranu ose s'e ka pranu. A din, domethonë kom pasë qesi komunikimi me kolegë unë a din. Qeshtu, t'njëjtin send e kom bo edhe, kushdo që. Edhe sot, veq jo një kreten që kurë s'i ka përlulë, e i kam lutë.

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendoj, ju me siguri u konë, jo ma lehtë, veç po thom meqenëse ju keni kalu me prej një mediumi n'tjetrin, u konë ma lehtë me iu jepë, me iu jepë... keni pasë njëfarë perspektive ma interdicipline për me ju ndihmu tjerve, se e keni provu. I keni testu qato...

**Sokol Beqiri:** Me këta, me këta të gjeneratës, kolegë ça e kanë kry, domethanë derisa kanë punu ata, gati me secilin kom pasë komunikim, qësi që, ama, miqësor jo profesor ksi që, kur e ka bo nuk po du as me e përmend me emra as kush e tek e. Por, prej artistave që jonë shumë të mirë domethonë ça ka, kur e kanë bo një send, më kanë thirrë, më kanë konsultu, ose m'kanë vetë, "Ça po mendon?" unë i kom thonë, ndonjëherë jom pajtu, ndonjëherë nuk jom pajtu, po kësi komunikimi kena pasë ndërmes veti. Një kohë të mirë. Derisa...

**Erëmirë Krasniqi:** E çfarë referenca ju ke jep shembull, kush jonë artistët që ju kishe thonë, "Hë, kqyre punën e qëtina për atë kohë".

**Sokol Beqiri:** Epo tash nvalet prej materialit që ma bjen ai. Kurr nuk e jap une një, një...

**Erëmirë Krasniqi:** Shabllon...

**Sokol Beqiri:** Jo, jo që ja punoj une. Ose që më pëlqen mu. Une ashtu ashtu muj me thonë shumë pak ka do njerëz që momente më pëlqejnë po kurrë nuk ja boj... ma s'pari ti më tregon mu edhe une në bazë të asaj e kqyri a, a, a po folë qajo, ndonjë prej sendeve që une mendoj që i di eventualish. Nuk mundësh ti tonve me ju thonë kqyre Filip Gastonin. Une tonve ju kisha thonë kqyreni Gastonin, mbas tij nuk e kisha lonë me pikturu askond veç çka me bo... pse me pikturu, çka ka bo ky...

**Erëmirë Krasniqi:** A don me ekspozu prapë?

**Sokol Beqiri:** Jo.

**Erëmirë Krasniqi:** A je i sigurtë? (qeshë)

**Sokol Beqiri:** Jo. Une e kom pasë, tash vonë njo, mundesh hala ndoshta me gjetë, Kosovë 2.0...

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, s'e kom pa...

**Sokol Beqiri:** Edhe, në fund edhe u konë qeshtu një pyetje. S'e di une tash pse në Dokumenta. Po fiks i kom thonë, "Kqyre ky o ni zanat që une e boj, osht' një zanat". Ti tha, "A je i sigurtë?" Nuk jom i sigurtë, po për me ekspozu duhët m'u konë, me, me vlerësu unë diçka që e kom një interes shumë të madh, qysh o n'Dokumenta. Ose thjesht aty ku e kom përdorë kom thonë, "Unë jom si prostitutkat. Po don me bo qef, ta boj, qikaq kushton" edhe për ekspozitë, po, qekaq kushton.

Nuk du, nuk kom, a din, krejt kjo ëshë luftë, a din, ti i thirrë në ekspozitë ata prej Anglisë, me kallzu diçka, me bo diçka, a din. Edhe e keni një trajtim mos të thom kurrfare në shumicën e rasteve. Une nuk kom ambicje për kurgjo ma shumë. Tash muj, nëqoftëse dikujt i pëlqen edhe ka nevojë me kallzu punën teme pse i futet n'kontekst, mundet me ndodhë une e ekspozoj po une lypi pare.

**Erëmirë Krasniqi:** E a mundeni...

**Sokol Beqiri:** E boj biznes, *real* bisnis.

**Erëmirë Krasniqi:** T'kjartë e boni... (qeshë)

**Sokol Beqiri:** Nuk boj kurgjo per veti edhe...

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendona, çka boni në kto raste kur përnime e gjeni, e shihni të arsyeshme me reagu karshi diçkafit, qoftë politike apo diçka shoqnore për të cilën ju e keni një qëndrim, që kishit mujt me sfidu përmes praktikës ju. Çka boni n'qasi raste, a nuk e boni hiç qatë punë?

**Sokol Beqiri:** Une me të thonë të drejtën nuk kom ambicje mo me reagu ndaj...

**Erëmirë Krasniqi:** Jo si ambicje por personalisht të jesh i përfshimë në diçka. Qysh e artikulonit?

**Sokol Beqiri:** Qysh i përfshimë?

**Erëmirë Krasniqi:** Nëse jo përmes artit...

**Sokol Beqiri:** Nuk përfshihna une...

**Erëmirë Krasniqi:** Ah nuk përfshiheni...

**Sokol Beqiri:** Jo, boj une hala. Qe përmes artit çka boj tash...

**Erëmirë Krasniqi:** S'po thom përmes artit, por po mendoj çka boni?

**Sokol Beqiri:** Qe përshebull, qe. E analizoj, tash po du me ju thonë atyne n'banesë teme që po e gjujnë bërllugun. Une p'e paguj, p'i pastroj shkallat se kërkush s'po i pastron. Kërkujt nuk i thom hajde participo. Edhe ai tipi ma nalt se une se s'guxon prej grusë me pi cigare n'banesë e ndalë nëpër shkalla. Meniherë t'nesërit edhe une e kom marrë një shkums edhe ja vizatoj rrumbullakin, nishi, a din si skenat e krimet qysh i bojnë. Edhe e përdorë një sens që e ki, që e ki përdorë për sende tjera përpara edhe shumë praktik. Edhe ai e sheh që s'po duhka me i gjujte se po më vjen marre me i thonë mos i gjuj qe. E gjej një mënyrë kur du me reagu po nuk kom ambicje me reagu ndaj fenomenve. Njëherë për njëherë jo.

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, për qata të pyeta qysh e artikulon qato që të preokupon?

**Sokol Beqiri:** Kqyre, definitivisht osht', osht' një send që osht' në ty. Po s'mundësh kurrë me u ndalë me mendu n'qato forma. Nuk mundesh m'u ndalë me mendu, ti apet mendon n'qatë formë. Une mendoj me sy, vizuelisht ma shumë, se me gojë, e me... këtë po them, osht' një zanat mu, mu, dëgjo për mu u konë njëfarë satisfacioni që mbas dhjetë vjetëve, osht' një dokumentim që osht' veç një zanat. Dhjetë vjet s'kom punu, edhe jom ulë e kom bo një projekt tjetër.

Osht' zanat, gjithkush mundet me mësu, mundet me bo, veç duhet me dashtë me bo. Edhe me konë i sigurtë që po don me bo qata. Nuk osht' kurgjo ma shumë, a din, qata m'kane pengu gjithë artistat. Nuk ka kurgjo t'jashtëzakonshme, ndryshe, osht' një send si krejt zanatet tjera n'botë edhe arti, edhe si tona senet. Qata nuk i du une se diçka mendojnë se jonë t'talentumë ose jonë ma ndryshe.

Domethonë, tash vonë e kom lexu, thotë, “Arti mundet me mbijetu veç nëse dorëzohet prej idesë me konë ndryshe. Edhe me i’u bashku mbretërisë t’gjithëfuqishme, profane, t’përditshmes”.

Nuk osht’ kurgjo ma shumë se një send tjetër, nuk osht’ kurgjo ma shumë se një status t’cilin, a din, që provojmë na me jep, status. Kom kallzu një qind herë, ata e kom përmend, që me bo një pikturë edhe një hamburger o njëjtë. Pasha Zotin. E merr bezin, une prej eksperiencës po foli se edhe Hamburgera maroj, e merr bezin edhe e merr tagarin këtu, edhe këtu ki ngjyrë t’kuqe, mishin, kepa osht’ e bardhë, mundesh edhe pak t’kuqe, sallata e gjelbërt, majoneza e sarit, keqapi i kuq. Edhe këtu i ki ngjyrnat.

Edhe tash kur ja nisë ti me reagu këtu, po qet kuq, një sasi, një formë edhe këtu mish. Edhe tash sa i ki inkorporu bukur strukturat, qaq ka me konë rezultati i mirë, qaq ka me konë kjo ma e shishme. E njëjta energji, i njëjti proces, e njëjta formë e t’mendimit osht’ aty. Veç hamburgerin e han edhe s’mendon, ose qakaq nuk e gjykon a ke i shijshëm, a i pa shijshëm se nuk e ke pa në muze. Por je i përpikët, kadale, noshta ka dalë diçka, noshta... A din, osht’ qajo droja që t’u ka kriju ty prej diçkafisht që osht’ ma shumë, a din. Ama mënyra, forma qysh mendon, n’cilën dushë, osht’ njisoj si me zi pasul, si me montu. Prit se shumë ka qesi, po dominon n’raport me kta, po ma prishe qita edhe ktij, po ta prishë storjen se... T’njëjtat forma...

**Erëmirë Krasniqi:** A mendon me shtu diçka...

**Sokol Beqiri:** Kur dushë, nuk osht’ problem hiç.

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, jo. Nëse ka diçka që mendon me plotësu...

**Sokol Beqiri:** Ah une me shtu? A din qysh, kjo noshta ka sende, se n’ksi muhabeti kështu kur nuk je i fokusum në një pyetje ashtu tipike, pyetje dhe pergjegjje t’përgaditësh, ja nisë me thonë ni send e len n’gjystë ose... Çka di une çka kom lonë n’gjystë, çka s’kom lonë n’gjystë...

**Erëmirë Krasniqi:** Jo veç nëse nihesh...

**Sokol Beqiri:** Ja, ja...

**Erëmirë Krasniqi:** Se përndyshe u kry. Shumë faleminderit!

**Sokol Beqiri:** Faleminderit prej juve!